

Datë __/__/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHËRBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Sherbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 79341400-0

Vlera e fondit limit: 9,978,000 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3*;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas *Shtojcës 10*;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1, si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e mëposhtme “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas balanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 30% të fondit limit vlerës së përlogaritur të kontratës**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2, c) dhe pika 3 e VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre

viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një **vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi për të dëshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit të tyre:

Stafi kryesor:

- **Drejtues i Projektit**

I cili duhet të ketë:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Menaxhim Projektsh, Administrim Publik, Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, Marketing, Ekonomi ose Inxhinieri Mjedisore.
- Përvoja profesionale: Minimumi 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e projekteve të komunikimit publik, ndërgjegjësimin mjedisor ose zhvillimit të qëndrueshëm, në nivel vendor ose kombëtar.

- **Ekspert i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun**

I cili duhet të ketë:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, Gazetari, Marketing, Shkenca Sociale ose Politike.
- Përvoja profesionale: Minimumi 3 vjet përvojë pune në hartimin dhe zbatimin e fushatave të komunikimit publik ose institucional.

- **Krijues i Përmbajtjes Vizuale dhe Audiovizuale (Designer / Videoproducent)**

I cili duhet të ketë:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Dizajn Grafik, Multimedia, Arte Vizuale ose Produksion Audiovizual.
- Përvoja profesionale: Minimumi 3 vjet përvojë në dizajn grafik, animacion, produksion audiovizual ose zhvillim përmbajtjeje për fushata komunikimi.

Për stafin e mësipërm duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Kontratë pune e vlefshme
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 3 (tre) muajore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Me certifikatë/ dëshmi profesionale ose diplomë.

Stafi Mbeshtetes:

- **Ekspert i Mjedisit / Edukimit Mjedisor**

I cili duhet të ketë:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Shkenca të Mjedisit, Ekologji, Biologji ose Inxhinieri Mjedisori.
- Përvoja profesionale: Minimumi 3 vjet përvojë në projekte që lidhen me edukimin mjedisor, ndërgjegjësimin publik ose menaxhimin e çështjeve mjedisore.

Për stafin mbështetës duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Kontratë pune e vlefshme
- I kontraktuar ose në rastin e të qenurit i punësuar, të rezultojë në listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 3 (tre) muajore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Me certifikatë/ dëshmi profesionale ose diplomë.

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar). Pikën 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kërkesa specifike për stafin të kërkuar është përcaktuar në kuadër të termave të referencës që janë të nevojshme për të realizuar objektin e shërbimit nga ku përcaktohet qartazi dhe profili i stafit të nevojshëm që është kërkuar.

1. Drejtues i Projektit: Drejtuesi i projektit do të ketë përgjegjësinë për planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të të gjitha aktiviteteve të fushatës, si dhe për sigurimin e përputhshmërisë së tyre me strategjinë e miratuar të komunikimit dhe objektivat e Bashkisë së Tiranës. Ky pozicion kërkon njohuri të thelluara në menaxhim projektesh, komunikim publik, planifikim strategjik dhe marrëdhënie institucionale, për shkak të natyrës gjithëpërfshirëse të fushatës dhe ndërveprimit të saj me komunitetin dhe mediat.

Ky nivel përvoje dhe kualifikimi është i nevojshëm për të siguruar kapacitet të plotë profesional dhe institucional në drejtimin e një projekti të ndërlidhur mes komunikimit dhe mjedisit, duke përfshirë bashkërendimin e aktorëve dhe implementimin e strategjive ndërgjegjëse.

2. Ekspert i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun: Eksperti i komunikimit do të ketë përgjegjësinë për hartimin e strategjisë së komunikimit, përgatitjen e mesazheve kryesore dhe menaxhimin e përmbajtjeve në platformat digjitale. Ai/ajo do të monitorojë impaktin publik të fushatës dhe do të sigurojë ndërveprim efektiv me audiencën përmes mediave sociale.

Përvoja e kërkuar garanton që komunikimi publik të jetë i strukturuar, me ndikim dhe në përputhje me standardet e Bashkisë së Tiranës, duke siguruar koherencë mes mesazhit, formës dhe kanaleve të komunikimit.

3. Ekspert i Mjedisit / Edukimit Mjedisor: Eksperti i mjedisit do të sigurojë që të gjitha mesazhet dhe materialet e fushatës të jenë të bazuara në fakte shkencore dhe kuadrin ligjor mjedisor kombëtar e vendor.

Do të ofrojë udhëzime për temat prioritare që lidhen me pastërtinë, riciklimin dhe ripëdorimin, ujin dhe ruajtjen e tij dhe energjinë e rinovueshme, duke ndihmuar në përkthimin e çështjeve teknike në mënyrë të kuptueshme për publikun.

Kërkesa për këtë profil është e domosdoshme për të garantuar saktësi tematike, përputhje me politikat mjedisore dhe zhvillimin e mesazheve që mbështeten në evidenca dhe praktika të qëndrueshme.

4. Krijues i Përmbajtjes Vizuale dhe Audiovizuale (Designer / Videoproducent): Ky ekspert është përgjegjës për konceptimin dhe realizimin e materialeve grafike dhe audiovizive të fushatës, përfshirë spote sensibilizuese, video edukative, infografikë dhe animacione për rrjetet sociale e komunikim outdoor.

Ai/ajo siguron cilësi të lartë grafike, koherencë vizuale me identitetin e Bashkisë dhe përshtatje teknike me platformat digjitale të shpërndarjes.

Ky profil garanton që të gjitha produktet vizuale dhe audiovizive të realizohen në standardet më të larta teknike dhe estetike, duke siguruar efikasitet në transmetimin e mesazheve sensibilizuese.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Gjithashtu Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet përkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të

paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jete kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën si mesiper, në përputhje me parashikimet e nenit 4 dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

SHËNIM: Në Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Sherbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personat përgjegjës për prokurim.